



Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KRPP - RKJN - PPRC

Nr. 91/2018
Dt. 26.12.2018



Për :	Të gjitha Autoritetet Kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik	Kopja: Arkivi i KRPP- së
Nga:	Kryetari i KRPP-ës z. Osman Vishaj <i>Osman Vishaj</i>	
Lënda:	Njoftim lidhur me zbatimin e Platformës së E-prokurimit nga 01.01.2019	
Datë:	26.12.2018	

Të nderuar,

Në bazë të nenit 87, paragrafit 2, nen-paragrafit 2.4, të Ligjit Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, si dhe në mbështetje të vendimit të Qeverisë së Republikës Kosovës, Nr.12/79 të datës, 15.03.2016, KRPP, i'u njofton si në vijim:

NJOFTIM

Me qëllim të funksionalizimit të plotë të platformës së prokurimit elektronik, KRPP, njofton, të gjitha Autoritetet Kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik se, nga data **01.01.2019**, të **gjitha procedurat e prokurimit** (vlera e vogël, e mesme dhe e madhe), **përveç atyre minimale dhe/ose procedurave të cilat nuk mund të zhvillohen përmes platformës, do të zhvillohen vetëm në formën elektronike.**

Pra përgatitja - dorëzimi i ofertave (nga ana e OE) dhe pranimi i ofertave (nga ana e AK) do të behën vetëm në formën elektronike nëpërmjet platformës së prokurimit elektronik – derisa dorëzimi i ofertave dhe aplikacioneve në formë fizike do të jetë i papranueshëm.